



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura III**

Komisioni për Legjislacion dhe Gjqësi  
Mbledhja nr. 20-2008  
Prishtinë, 16 shtator 2008, ora 10:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

**PROCESVERBAL**

i mbledhjes së Komisionit për Legjislacion dhe Gjqësi

**Në mbledhje morën pjesë:** Bahri Hyseni, Adem Salihaj, Selvije Halimi, Kolë Berisha, Lutfi Haziri, Bajram Kosumi, Adem Hajdaraj, Riza Smaka, Ramadan Gashi dhe Džezair Murati.

**Mungoi:** Branisllav Grbiq.

**Nga stafi mbështetës i Komisionit në mbledhje ishin të pranishëm:** Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Sulltane Gashi.

Në mbledhje morën pjesë: Fitore Zeneli - nga KDI, Reshit Gashi - NDI, Lumnije Murati – ZPRK, Hysni Ismajli - Departamenti Ligjor KK, Fatlum Demiri - praktikant nga GP i AAK dhe Shpëtim Haziri - GP i LDK, Megun Kossiakoff - OSBE, Lejla Selimi – OSBE, Ramadan Islami – OSBE, Valdet Sadiku – ICO, Nexhmije Berisha GP i LDK, Arsim Avdijaj – Kuvendi i Republikës së Kosovës.

**Mbledhjen e kryesoi:** Bahri Hyseni, kryetar i Komisionit.

**RENDI I DITES**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 8 korrikut 2008;

3. Shqyrtimi i propozimamendamenteve në Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të përkohshëm të procedurës penale të Kosovës nr. 2003/26, në pajtim me vendimin e Kuvendit të 30 korrikut 2008, lidhur me riprocedimin e ligjeve të pashpallura nga PSSP-ja;
4. Shqyrtimi i propozimit të Ligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit të përkohshëm penal të Kosovës;
5. Përgatitjet për vizitën në Burgun e Dubravës më 17 shtator 2008;
6. Të ndryshme.

### **1. Miratimi i rendit të ditës**

Kryetari i njoftoi të pranishmit për propozimin e rendit të ditës.

*Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.*

### **2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 8 korrikut 2008**

**Kryetari** – I pyeti anëtarët e Komisionit a kanë vërejtje eventuale për procesverbalin.

*Procesverbali u miratua pa vërejtje.*

### **3. Shqyrtimi i propozimamendamenteve në Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të përkohshëm të procedurës penale të Kosovës nr. 2003/26, në pajtim me vendimin e Kuvendit të 30 korrikut 2008, lidhur me riprocedimin e ligjeve të pashpallura nga PSSP-ja**

**Kryetari** – Lidhur me shqyrtimin e propozimamendamenteve në Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të përkohshëm të procedurës penale e hapi diskutimin. U shqyrtuan amendamentet e propozuara dhe u miratuan nga anëtarët e pranishëm të Komisionit.

**Selvije Halimi** – E mori fjalën dhe e ngriti çështjen e ndalimit të personave nga organet kompetente dhe kërkoi që kjo të jetë në harmoni me Kushtetutën në të cilën është caktuar 48 orë, kurse në Kodin e përkohshëm të procedurës penale është paraparë 72 orë.

**Adem Salihaj** - Duke u ndërlidhur me parafolësit shtoi se kjo duhet të jetë konform dispozitave kushtetuese dhe shtoi se ky ndalim duhet të jetë siç është paraparë në Kushtetutë.

**Kryetari** - Duke diskutuar për këtë çështje theksoi se do të konsultohet edhe me Shoqatën e Prokurorëve

- *Komisioni i miratoi njëzëri propozimamendamentet e shqyrtuara të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të përkohshëm të procedurës penale.*

#### **4. Shqyrtimi i propozimit të Ligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit të përkohshëm penal të Kosovës**

**Kryetari** – Lidhur me shqyrtimin e propozimamendamenteve në Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të përkohshëm penal e hapi diskutimin. U shqyrtuan amendamentet e propozuara dhe u miratuan nga anëtarët e pranishëm të Komisionit.

*Komisioni njëzëri i miratoi amendamentet e shqyrtuara në Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të përkohshëm penal.*

#### **5. Përgatitjet për vizitën në Burgun e Dubravës më 17 shtator 2008**

Në pikën e pestë të rendit të ditës kryetari i Komisionit i njoftoi anëtarët e tij për përgatitjet që janë bërë dhe për agjendën që do ta kenë në vizitën e Burgun të Dubravës.

Procesverbali e hartoi stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetari i Komisionit

---

Bahri Hyseni